



Hapet thirrja për mobilitete(bursa)studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus + në University of Chieti, Itali

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursapërmobilitete për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në University of Chieti, (UniversitadegliStudi"G. d'Annunzio"Chieti - Pescara), Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, tëUniversitetit Politeknik të Tiranës.

Kohëzgjatja e bursave për studentët: Semestri i II i vitit akademik 2024 – 2025, 5 muaj (1 semester), nga 01 mars deri 31 korrik 2025;

Numri total i studentëve: 4

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje ePasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash estudimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë egjuhës së huaj* (Italisht ose Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.

Përparësi në nominimin e studentëve, si dhe për mbështetje financiare të tyre gjatë mobilitetit, kanë studentët që u përkasin grupeve të disavantazuara. (Studentë, prindërit e të cilëve kanë vdekur në krye të detyrës; studentë me ndihmë financiare; studentë me nevoja të veçanta; studentë prindërit e të cilëve kanë nevoja të veçanta, studentë që kanë marrë statusin e jetimit; studentë që kanë qenë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore; studentë të grupeve etnike; studentë, prindërit e të cilëve ishin të dënuar të regjimit komunist; studentë, prindërit e të cilëve janë në pension etj.)



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Chieti lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni më poshtë:

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Për t'u njohur me listën e lëndëve, si dhe për një informacion të plotë mbi University of Chieti ju lutemi klikoni te: [Pagina non trovata / Università degli Studi "G. d'Annunzio" Chieti – Pescara \(unich.it\)](#)

<https://idclm24.unich.it/piano-di-studio?&gruppo=18394>

https://www.unich.it/sites/default/files/2024-09/guida_studente_erasmus.pdf

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 25 tetor 2024, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al